

31335

V E N D I M

**Per Regjistrimin si Person Juridik te
Shoqerise Anonime "Operatori i Sistemit te Transmetimit" sh.a.
Me shkurtimin "OST" sh.a.**

Ne Tirane, sot me date 14/7/2004 (dymije e kater), une gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, B. Kungu mora ne shqyrtim kerkesen e bere nga Drejtori i Pergjithsehm i Shoqerise Anonime "Operatori i Sistemit te Transmetimit" sh.a. me shkurtimin "OST" sh.a. z.Gazmend DACI, per regjistrimin e kesaj shoqerie si person juridik dhe

K O N S T A T O V A

Se Aksioneri i Vetem sh.a. KESH, me vullnet te lire ka themeluar Shoqerine Anonime "Operatori i Sistemit te Transmetimit" sh.a. me shkurtimin "OST" sh.a., me objekt te veprimtarise :

1. Drejtimi dhe menaxhimi i integruar per funksionimin e qendrueshem te sistemit te transmetimit duke koordinuar nevojat per energji elektrike te vendit me mundesine e mbulimit te tyre nga burime te ndryshme ;

a) Menaxhon tregun e brendshem te energjise elektrike si dhe merr pjese ne tregun rajonal dhe me gjere te energjise elektrike ;

b) Menaxhimi i çdo tranzitimi te energjise elektrike ndermjet sistemeve te huaja qe shfrytezohen rreth shqiptar te energjise elektrike ;

c) Furnizimi me energji elektrike te klienteve te lidhur drejtperdrejt me sistemin e transmetimit ;

d) Importi dhe eksporti i energjise elektrike.

2. Mirembajtja dhe zhvillimi i asetave te transmetimit si dhe zhvillimi dhe zgjerimi i sistemit te transmetimit ne koordinim te plote me funksionet e gjenerimit dhe te shperndarjes apo konsumatret e energjise elektrike ;

a) Zhvillimi i sistemit te transmetimit, ne perputhje me parashikimet afatgjata dhe planet e zhvillimit te sektorit te energjise elektrike duke perfshire dhe lidhjet ndersisteme me sistemet elektroenergjitike te vendeve fqinje.

b) Mirembajtja dhe zhvillimi i asetave ndihmese te transmetimit ;

Shoqeria mundet te realizoje çdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj brenda limiteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Shoqeria mund te kryje çdo veprim me qellim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve te nevojshme per realizimin e veprimtarive te saj per te cilat kerkohen keto dokumenta administrative.

Selia e shoqerise do te jete ne Bllokum "Vasil Shanto", Tirane.

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete pa afat te caktuar.

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 2.000.000 leke (dymiljon), dhe eshte ndare ne 2.000 (dymije) aksione me vlere nominale 1.000 (njemije) leke secili. Kapitali i shoqerise eshte derdhur dhe nenshkruar nga Aksioneri i Vetem sh.a. KESH. Aksionet jane te formes nominative dhe lirisht te transferueshme sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi per privatizimin.

Aksioneri i Vetem pergjigjet per humbjet e shoqerise ndaj te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e shoqerise.

Kapitali i shoqerise mund te rritet apo te zvogelohet ne menyren dhe formen e parashikuar ne ligj.

Anetare te pare te Keshilli Mbikqyres te shoqerise jane :

1. Andin HARASANI
2. Alfred RUSHAJ
3. Petraq LIKA
4. Bujar LEKA
5. Andi SULA
6. Ilir KANINA

Eksperte te Pare Kontabel te Autorizuar do te jene :

- Kosta NIKA
- Jorgji BOLLANO

Drejtor i Pergjithshem i Shoqerise "OST" sh.a. do te jete z.Gazmend DACI.

Mendoj se kerkesa e paraqitur nga Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise Anonime "OST" sh.a. eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar",

V E N D O S A

Te pranoj kerkesen e Drejtorit te Pergjithshem te **Shoqerise Anonime "Operatori i Sistemit te Transmetimit" sh.a.** me shkurtimin "OST" sh.a. per regjistrimin e kesaj shoqerie si person juridik ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me Aksioner te Vetem sh.a. KESH dhe objekt veprimtarie :

1. Drejtimi dhe menaxhimi i integruar per funksionimin e qendrueshem te sistemit te transmetimit duke koordinuar nevojat per energji elektrike te vendit me mundesine e mbulimit te tyre nga burime te ndryshme ;
 - a) Menaxhon tregun e brendshem te energjise elektrike si dhe merr pjese ne tregun rajonal dhe me gjere te energjise elektrike ;
 - b) Menaxhimi i çdo tranzitimi te energjise elektrike ndermjet sistemeve te huaja qe shfrytezojne rrjetin shqiptar te energjise elektrike ;
 - c) Furnizimi me energji elektrike te klienteve te lidhur drejtperdrejt me sistemin e transmetimit ;
 - d) Importi dhe eksporti i energjise elektrike.

2. Mirembajtja dhe zhvillimi i asetëve të transmetimit si dhe zhvillimi dhe zgjerimi i sistemit të transmetimit në koordinim të plotë me funksionet e gjenerimit dhe të shpërndarjes apo konsumatret e energjisë elektrike ;

a) Zhvillimi i sistemit të transmetimit, në përputhje me parashikimet afatgjata dhe planet e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike duke përfshirë dhe lidhjet ndërsistimore me sistemet elektroenergjitike të vendeve fqinje.

b) Mirembajtja dhe zhvillimi i asetëve ndihmëse të transmetimit ;

Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Shoqëria mund të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj për të cilat kerkohen këto dokumenta administrative.

Selia e shoqërisë do të jetë në Bllokum "Vasil Shanto", Tiranë.

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Kapitali themelues i shoqërisë do të jetë 2.000.000 leke (dymiljon), dhe është ndarë në 2.000 (dymijë) aksione me vlerë nominale 1.000 (njemijë) leke secili. Kapitali i shoqërisë është derdhur dhe nënshkruar nga Aksioneri i Vetëm sh.a. KESH. Aksionet janë të formës nominative dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për privatizimin.

Aksioneri i Vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë ndaj të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë mund të rritet apo të zvogëlohet në mënyrën dhe formën e parashikuar në ligj.

Anetare të parë të Këshilli Mbikqyres të shoqërisë janë :

1. Andin HARASANI
2. Alfred RUSHAJ
3. Petraq LIKA
4. Bujar LEKA
5. Andi SULA
6. Ilir KANINA


Eksperte të Parë Kontabel të Autorizuar do të jenë :

- Kosta NIKA

-Jorgji BOLLANO

Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë "OST" sh.a. do të jetë z.Gazmend DACI

Kunder këtij vendimi lejohet të bëhet ankimi në Gjyктën e Apelit.

GJYQTARIA


**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ANONIME
"OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT"**



Ne Tirane, sot me 09 Korrik 2004, u hartua ky Akt – Themelimi nga:

Z. Andis Harasani, Drejtor i Pergjithshem i sh.a. KESH – it qe vepron si perfaqesues i Ortakut te Vetem, sh.a. KESH.

Formohet shoqeria anonime "Operator i Sistemit te Transmetimit" me shkurtimin "**OST**" sh.a. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me Aktin e Themelimit e Statutin e saj.

1. Shoqeria e ka seline e saj ne **Blokun "Vasil Shanto", Tirane**, Shqiperi dhe mund te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ashtu dhe jashte saj.
2. Shoqeria eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri Anonime pa Oferte Publike.

3. Objekti i shoqerise eshte:

1. Drejtimi dhe menaxhimi i integruar per funksionimin e qendrueshem te sistemit te transmetimit duke koordinuar nevojat per energji elektrike te vendit me mundesine e mbulimit te tyre nga burime te ndryshme;
 - (a) Menaxhon tregun e brendshem te energjise elektrike si dhe merr pjese ne tregun rajonal dhe me gjere te energjise elektrike.
 - (b) menaxhimi i cdo tranzitimi te energjise elektrike, ndermjet sistemeve te huaja, qe shfrytezojne rrjetin shqiptar te energjise elektrike.
 - (c) furnizimi me energji elektrike te klienteve te lidhur drejtperdrejt me sistemin e transmetimit.
 - (d) Importi dhe eksporti i energjise elektrike
2. mirembajtja dhe zhvillimi i aseteve te transmetimit si dhe zhvillimi e zgjerimi i sistemit te transmetimit ne koordinim te plote me funksionet e gjenerimit dhe te shperndarjes apo konsumatoret e energjise elektrike;
 - (a) zhvillimi i sistemit te transmetimit, ne perputhje me parashikimet afatgjata dhe planet e zhvillimit te sektorit te energjise elektrike duke perfshire dhe lidhjet ndersistimore me sistemet elektroenergjetike te vendeve fqinje.
 - (b) mirembajtja dhe zhvillimi i aseteve ndihmese te transmetimit;

Shoqeria mundet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Shoqeria mund te kryeje cdo veprim me qellim marrjen e lejeve , autorizimeve, licensave dhe miratimeve te nevojshme per realizimin e veprimtarive te saj per te cilat kerkohen keto dokumenta administrative.

4. Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat te caktuar.
5. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2,000,000 (dymilion) leke dhe eshte i ndare ne 2000 (dymije) aksione me vlere nominale 1000 (njemije) leke secili. Kapitali i shoqerise eshte derdhur dhe nenshkruar teresisht nga aksioneri i vetem, sh.a. KESH.
6. Aksionet jane te formes nominative dhe lirisht te transferueshme sipas ligjit shqiptar ne fuqi per privatizimin.
- Aksionari pergjigjet per humbjet e shoqerise ndaj te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e shoqerise.
 - Kapitali i shoqerise mund te rritet apo te zvogelohet, ne menyren dhe formen e parashikuar me ligj.
6. Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon ne ditën e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe perfundon me 31 Dhjetor 2001.
7. Anetare te pare te Keshillit Mbikqyres te shoqerise jane
1. Z. Andis Harasani
 2. Z. Alfred Rushaj
 3. Z. Petraq Lika
 4. Z. Bujar Leka
 5. Z. Andi Sula
 6. Z. Ilir Kanina
8. Ekspertet e pare kontabel te autorizuar do te jene;
1. Z. Kosta Nika
 2. Z. Jorgji Bollano
9. Ky Akt i Themelimit te Shoqerise Anonime perpilohet ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe

Per AKSIONERIN THEMELUES

DREJTORI I PERGJITHSHEM



ANDIS HARASANI